



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 37, datë 28.01.2021

PËR

**VLERËSIMIN E PËRSHPEJTUAR ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT
{...}, PËR VITIN 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 97, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatori z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARIT

E – ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR
ÇDO KRITER VLERËSIMI.

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari përshkuan rrethanat dhe faktet e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në çështjet e kategorisë “seancë paraprake”, faktet evidentohen në përputhje me provat pjesë e fashikullit të procedimit penal. Përcakton natyrën e çështjes dhe fazën procedurale në të cilën është çështja objekt gjykimi (*seancë paraprake – dërgim në gjyq dhe kërkesës për revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit*).

Lidhur me identifikimin e ligjit të zbatueshëm, evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat procedurale penale (*nenet 151 dhe 152 të K.Pr.Penale*)¹ në lidhje me vlerën dhe fuqinë provuese të provave të administruara; dispozitat procedurale penale në lidhje me llojin e provave dokument (*neni 191 i K.Pr.Penale*)²; dispozitat procedurale penale për gjykimin e

¹ Vendimi nr. 65 datë 17.10.2019; Vendimi nr. 32 datë 30.04.2019; Vendimi nr. 27 datë 02.04.2019;

² Vendimi nr. 65 datë 17.10.2019;

shkurtuar (*nenin 405/6 i K.Pr.Penale*)³ në funksion të argumentimit të pranimit të kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar; dispozitat procedurale penale (*neni 246/6 i K.Pr.Penale*)⁴ në funksion të marrjes së informacionit nga ana e organit të akuzës mbi gjendjen e procedimit penal, si dhe dispozitën materiale dhe dispozitat materiale të ligjeve të posaçme (*nenin 11 të ligjit nr. 7975 datë 26.07.1992 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope*)⁵, gjatë analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të veprës penale.

Në lidhje me konfliktin e normave, në vendimet e vëzhguara nuk rezultojnë të jetë evidentuar konflikt i normave procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Në tërësi, referuar të dhënave, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale, që gjejnë zbatim mbi secilin fakt.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari në përputhje me rrethanat e faktit dhe procedurale të çështjes, interpreton kuptimin e ligjit procedural (*nenit 405/6 në lidhje me nenin 332/dh shkronja “c” të K.Pr.Penale*)⁶ për të argumentuar dhe analizuar arsyet e pranimit të kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar; interpreton dispozitën ligjore në lidhje me ndarjen e çështjes (*neni 93 pika 1 shkronja “ç” e K.Pr.Penale*)⁷ për të argumentuar se nga ndarja e çështjes nuk dëmtohet vërtetimi i fakteve; interpreton dispozitat ligjore në lidhje me llojin, marrjen e provës dhe fuqinë provuese të tyre (*nenin 152,191,192 dhe 364 të K.Pr.Penale*)⁸ në lidhje me papërdorshmërinë apo manipulimin dhe pavërtetësinë e provave, si dhe interpreton dispozitat procedurale (*neni 190/1/a të K.Pr.Penale*)⁹ në lidhje me disponimin e provave.

Në lidhje me dispozitat e ligjit penal material, evidentohet se gjyqtari interpreton dispozitat materiale, në lidhje me kualifikimin juridik të faktit penal atribuar të pandehurit, mbështetur në rrethanat e faktit dhe provat e marra në shqyrtim. Referuar fazës procedurale të çështjes (*seancë paraprake me objekt dërgim në gjyq*), evidentohet se gjyqtari interpreton nenet 283/a/1/22 apo edhe nenit 283/a/2-22 të K.Penal, në përputhje me rrethanat e fakteve dhe

³ Vendimi nr. 27 datë 02.04.2019;

⁴ Vendimi nr. 110 datë 11.03.2019;

⁵ Vendimi nr. 32 datë 30.04.2019; Vendimi nr. 27 datë 02.04.2019;

⁶ Vendimi nr. 32 datë 30.04.2019; Vendimi nr. 27 datë 02.04.2019; Vendimi nr. 65 datë 17.10.2019;

⁷ Vendimi nr. 65 datë 17.10.2019;

⁸ Vendimi nr. 65 datë 17.10.2019;

⁹ Vendimi nr. 32 datë 30.04.2019;

provave, konform nenit 332/dh/1 pika “a” e K.Pr.Penale. Këtë vlerësim gjyqtari e bën për aq sa është e mundur të vlerësohet në seancë paraprake, duke treguar kujdes që vlerësimi i hollësishëm i përket fazës së gjykimit të çështjes e vlerësimit të provave, në kushtet e debatit dhe kontradiktoritetit të gjykimit.

Në vendimet e administruara, evidentohet aftësia e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, në lidhje me arsyet e aplikimit të procedimit me gjykim të shkurtuar, në lidhje me ndarjen e çështjes, duke analizuar dhe faktet e ndryshme penale për të cilat akuzohen të pandehurit, në kuadër të përcaktimit të kompetencës lëndore, në funksion të marrjes së informacionit nga ana e organit të akuzës mbi gjendjen e procedimit penal, si dhe në lidhje me format e kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”. Gjithashtu, identifikohet dhe reflektohet përmbushja e parimit të kontradiktoritetit e barazisë së palëve, si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor.

Gjithashtu, evidentohet në një rast¹⁰ përdorimi i Konventave Ndërkombëtare, si Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit dhe Konventa Penale e Këshillit të Europës “Për Korrupsionin”, në shërbim të interpretimit të ligjit material (*nenit 319/ç të K.Penal*).

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruesese.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjin e posaçëm (si ligji nr. 7975 datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”), apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine, por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

¹⁰ Vendimi nr. 65 datë 17.10.2019;

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të qartë, sipas pjesëve përbërëse të vendimit.

Konkretisht, evidentohet se në çështjet e kategorisë “krime”, vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese si dhe dispozitivin. Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupit gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishëm në proces. Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar analizohen: (i) rrethanat procedurale. Në këtë nënpjesë, gjyqtari rendit veprimet hetimore të kryera nga ana e organit të akuzës dhe më pas pasqyron vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në seancë paraprake, për të vijuar me kërkesat procedurale që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit, të çështjes në themel, si refuzimi apo pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar, mosndarja e çështjes, etj (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes të ndara veç nga provat (në prezantimin e fakteve gjyqtari nuk bën një lidhje të provave me faktin penal të evidentuar, por duke i paraqitur ato veçmas). (iii) Provat e marra gjatë gjykimit. (iv). Pretendimet e palëve gjatë gjykimit. (v) Vlerësimi dhe analiza juridike, në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm dhe elementet e tij, në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionet e tij. Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit.

Në tre çështjet të kategorisë “seanca paraprake” me objekt dërgim në gjyq, konstatohet se vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin. Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishëm në proces. Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilat në mënyrë të detajuar analizon: (i) Rrethanat procedurale të kërkesës, në të cilën gjyqtari

pasqyron shkurtimisht veprimet procedurale të kryera nga ana e organit të akuzës, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, deri në regjistrimin në gjykatë të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, (ii) rrethanat e fakteve të çështjes, (iii) provat, të listuara këto në mbështetje të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, (iv) pretendimet e palëve gjatë gjykimit dhe (v) ligji i zbatueshëm dhe vlerësimi i gjykatës, në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm dhe elementët e tij, në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij. Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se në pjesën e dispozitivit të dërgimit të çështjes në gjyq, gjykata nuk parashikon faktin që ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim, për t'u bërë i kuptueshëm në mënyrë të qartë edhe nga mosnjohësit e ligjit nëse vendimi mund të ankimohet apo jo.

Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, zbaton rregullat e shkrimit ligjor sipas metodës *IRAC*, ku identifikon rrethanat procedurale të çështjes, faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta, në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se arsyetimi i vendimit përfundimtar ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal. Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit penal, shtjellohen argumentet e gjykatës në mënyrë logjike, duke u integruar me faktet e provuara në gjykim dhe duke u ndalur herë pas herë dhe kur është vlerësuar me vend, në analizën e formave të bashkëpunimit si rrethanë cilësuese ose rënduese, sipas rastit, në kuptimin e tentativës, format e veçanta të bashkëpunimit, kuptimin e trafikimit dhe format e posaçme të tij.

Në tërësi, në të gjitha aktet e analizuar rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale.

Gjyqtari në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e faktit penal objekt shqyrtimi, duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në çështjen konkrete, jo vetëm referohen ose citohen kur është e nevojshme, por analizohen dhe interpretohen në raport me faktet e çështjes.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda afateve ligjore të parashikuara në K.Pr.Penale, me përjashtim të 6 (gjashtë) çështjeve nga kategoria “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe 1 (një) çështjeje nga kategoria “seancë paraprake”.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (7 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon afat ligjor (35 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 20 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Konstatohet se në rastin e kërkesës me nr. 22 regjistri, datë regjistrimi 07.01.2019, me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, është kaluar afati 30 ditor i parashikuar në nenin 332/3 të K.Pr.Penale, me 11 ditë. Rezulton se me vendimin e ndërmjetëm, të datës 30.01.2019, gjyqtari ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal me qëllim plotësimin e hetimeve dhe lënien prokurorit një afat 10 ditor, deri në datën 13.02.2019, për kryerjen e veprimeve

procedurale. Duke llogaritur afatin e shqyrtimit të kësaj çështje, pa përfshirë periudhën në të cilin i është lënë afat prokurorit për plotësimin e hetimeve, rezulton se çështja është gjykuar brenda afatit ligjor, konkretisht, çështja është gjykuar për 28 ditë.

Sa më sipër, çështja do të konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor, dhe raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor është 6 çështje, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon afat ligjor, 35 çështje, duke rezultuar se gjyqtari ka gjykuar 17.1 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “11-20 %”, duke u pikëzuar me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të 1 (një) çështjeje nga kategoria “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe 1 (një) çështjeje nga kategoria “Seancë paraprake”.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të standardit minimal kohor (2 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (16 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 12.5% të çështjeve në tejkallim të standardit minimal kohor.

Konstatohet se në rastin e kërkesës me nr. 40 regjistri, datë regjistrimi 06.03.2019, me objekt “Pushimin e procedimit penal nr.274/2017”, është tejkalluar afati 2 muaj ose 60 ditë, i parashikuar si standard minimal kohor, me 56 ditë. Rezulton se me vendimin e ndërmjetëm, të datës 08.04.2019, gjyqtari ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal, me qëllim plotësimin e hetimeve dhe lënien afat prokurorit për kryerjen e veprimeve procedurale. Pas plotësimit të detyrave të lëna nga gjykata, prokurori ka risjellë çështjen në gjykatë në datën 02.07.2019, datë në të cilën gjykata ka disponuar me vendim përfundimtar. Duke llogaritur afatin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, pa përfshirë periudhën në të cilin i është lënë afat prokurorit për të plotësuar detyrat e lëna nga gjykata, rezulton se çështja është gjykuar brenda standardit minimal kohor, konkretisht është gjykuar për 1 muaj e 1 ditë, ose 32 ditë.

Sa më sipër, çështja do të konsiderohet e përfunduar brenda standardit minimal kohor, dhe raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të standardit minimal kohor (1 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (16 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 6.25 % të çështjeve në tejkallim të standardit minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “0-10 %”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardet minimale kohore për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve”, duke u pikëzuar me 4 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2019, pra për periudhën e vlerësimit është 96.2%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi 93-99%”, duke u pikëzuar me 8 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me

afatin procedural të parashikuar në ligj, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përfshirur ato pa palë kundërshtare, për kategorinë “Krime” është 4 seanca dhe për kategorinë “Sanca paraprake” është 2.7 seanca, pra në total, numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh është 3.35 seanca.

Po kështu, nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues apo angazhimit të anëtarëve të trupit gjykues në aktivitete pune, rezultojnë seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit.

Shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjykatës, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të mos bëhet shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në proces.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-productive”, rezultojnë se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 3.35 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masa të nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka venë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe gjykata rezulton të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetëm për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse, në përputhje edhe me llojin e gjykimit.

Në përgjithësi, evidentohet se seancat gjyqësore kanë filluar pa vonesë. Në ato seanca në të cilat procesi ka filluar me vonesë, nga ana e gjykatës është relatuar gjithmonë shkaku, vonesa këto të shkaktuara për shkaqe të pavarura nga ana e gjykatës.

Po kështu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në procesverbalin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, evidentohet se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentet janë lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e shortit, urdhrin e formimit të turpit gjykues, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik evidentohet se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seancë, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e administruara për herë të parë në seancë për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
94	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit. Nuk evidentohen që nga ana e gjyqtarit të ketë shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jetë regjistruar pranë ILD një ankesë, trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 1372/3 Prot., datë 06.11.2020, ku rezulton të jetë vendosur “Arkivimi i ankesës së ankueses Eriona Fino, regjistruar me nr. 1372 Prot., datë 29.06.2020”.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuar në vendimin e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit. Nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmëritë e publikut. Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 297/25 Prot., datë 30.09.2020, konkludohet se gjyqtari nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme, apo cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 40 pikë.*

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit, ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se për periudhën 01 janar 2019 – 31 Dhjetor 2019, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, duhet të vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “I lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivelin “Shumë e lartë”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari {...}, përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 8 (tetë) aktivitet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit/pjesëmarrësit, konvertuar në numër ditësh 26.5 ditë¹¹. Kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 20 pikë.

¹¹ Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari {...}, përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 5 (pesë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit, me tema të ndryshme në fushën e të drejtës materiale dhe procedurale penale.

Lidhur me disponueshmerinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari gjatë vitit 2019, ka qenë pjesëmarrës në grupin e pedagogëve për hartimin e kurrikulës së trajnimit për kancelarët e gjykatave, konkretisht në modulën “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”. Në drejtim të gatishmërisë së gjyqtarit për pjesëmarrje në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, rezulton se gjyqtari gjatë vitit 2019 është angazhuar në studimin “Mbi Nevojën e hartimit të një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit”, financuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga “Save the Children”, në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara. Po kështu, është angazhuar si anëtar në Komitetin Drejtues të Instrumentit Horizontal të Këshillit të Europës. Ka qenë pjesëmarrës në Konferencën Rajonale mbi “Administrimin e Gjykatave dhe Menaxhimin e Çështjeve”, Nëntor 2019, organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; në Konferencën “Administrimi, menaxhimi dhe përdorimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, nëntor 2019, organizuar nga Ministria e Drejtësisë; në tryezën e konsultimit të akteve nënligjore të reformës së drejtësisë, Janar 2019, organizuar nga Ministria e Drejtësisë; në tryezën e diskutimit për sistemin e vlerësimit, Nëntor 2019, organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; në seminarin “Forcimi i cilësisë dhe efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri”, Janar 2019, organizuar nga Këshilli i Europës, projekti SEJ II.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, evidentohet se gjyqtari është bashkëautor në hartimin e “Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore”, konkretisht të kapitujve të parë dhe të katërt të tij. Nga aktet e dorëzuara nga gjyqtari, bashkëlidhur formularit, nuk evidentohet periudha e publikimit të këtij komentari. Në këto rrethana, në datën 04.12.2020, nëpërmjet komunikimit elektronik, i është kërkuar gjyqtarit informacion lidhur me periudhën e botimit të komentarit. Pas informacionit të dërguar nga gjyqtari, rezultoi se “Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore” është hartuar gjatë vitit 2017, duke mos u përfshirë kështu në periudhën e vlerësimit 01 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2019.

Po kështu, lidhur me studimin “Mbi nevojën e hartimit të një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit”, evidentohet se materiali i dorëzuar nuk është shoqëruar me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për treguesin “Publikimet ligjore akademike”, pikëzohet me 0 pikë.

KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

NDARJA F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER

VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer prej tij, propozon nivelin e vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit.

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	94	Shkëlqyeshëm

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	389	Shkëlqyeshëm

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT

1. AFTËSITË PROFESIONALE			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT			
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi 93-99 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e

gjqësore	për shmangien e atyre jo-produktive	2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë

C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e	Shumë e lartë

		ankesave	
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			389
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqye

RELATOR